SH.P.K. "BENI DONA PLAST"
Nr./No. 101/17
Dt. 20.10.2017

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
PRISHTINË-PRISTINA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 399/17
Datë/Datum 20.10.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: *Policia e Kosovës*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *214/17/1875/2-2-1 dhe ai i brendshëm: 214/17/037/221*

Sa i përket tenderit për: Kundër Vendimit të AK-së -Policia e Kosovës i datës 11.10.2017-Për Aktivitetin e Prokurimit :*Shërbime Hoteliere në Hapësirat e Objekteve të PK-së (Lot 1 dhe Lot 2)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Kompania 'BENI DONA'Plast Shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Imzot Nikë Prelaj, Ulpianë ,pn
(Adresa)
Komuna e Prishtines — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
044[redacted]3 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Z. Ragip Mustafa
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
[redacted]m
(Adresa elektronike)

20.10.2017 — _____
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

PËRGJEGJËSI I TË BURIMEVE NJERËZORE "BENI DONA PLAST" PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

prokurimit dhe e njejta është shkelje e rëndë, sipas Rregullores nr.2/2017, neni 7 pika 3. Me datë 30.06.2017 OE Beni Dona Plast ,ka deponuar Kërkesën për Rishqyrtim pranë AK-Policia e Kosovës, ndërsa me datë 03.07.2017 ka pranuar Vendimin nga AK me të cilin iu është refuzuar Ankesa si e pa bazuar dhe është vertetuar Njoftimi për anulimin e kontratës.OE Beni Dona Plast brenda afatit ligjor me datë 11.07.2017 pranë OSHP-së ka ushtruar Ankesë kundër këtij Vendimi me propozim që lënda të kthehet në rivlersim .Me datë 07.08.2017 OE ka pranuar Akt Përcjellës-Raportin e eskpertizës lidhur me Ankesen e parashtruar të cilen pas shqyrtimit është pajtur me vlerësimin e ekspertit duke e njoftuar OSHP-në, për një pajtim të tillë , pas gjithë kësaj procedure OE me datë 23.08.2017, ka pranuar nga OSHP Vendimin e datës 23.08.2017 me nr.215/17, me të cilin aprovohet si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik Beni Dona Plast sh.p.k, dhe lënda të kthehet në RI vlerësim .

Sekendejmi, OE me datë 02.10.2017, përmes email-it zyrtar ka pranuar Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar me të cilin AK e ka njoftuar për eliminim si i pa përgjegjshëm me propozim që ky aktivitet të anulohet , citoi "Komisioni vlerësues përfundon se oferta e pranuar edhe pse i ka plotësuar kriteret e kërkuara në dosje të tenderit, nuk mund të jetë e përgjegjshme për arsye se çmimet e ofruara nga OE janë çmime të larta të krahasuara me çmimet e kërkesës së hartuar nga komisioni i njësisë kërkuese si dhe me çmimet e byfeve në Institucioneve të Kosovës".Kundër këtij Njoftimi –Letër Standarde për eleminim OE ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim me datë 06.10.2017, me propozim që të revokohet vendimi për eleminim jo ligjor dhe mundësimit të rivlerësimit të ofertës për këtë aktivitet të prokurimit.Me datë 11.10.2017, OE ka pranuar nga AK , Vendimin mbi refuzimin e ankeses si të pa bazuar , kundër të cilit OE brenda afatit ligjor e pashtron këtë Ankesë pranë OSHP-së.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Pas analizimit te dosjes se tenderit per prokurimin e Shërbime Hoteliere në Hapsirat e Objekteve të PK-së *me nr. prokurimi 214/17/1875/221* dhe ate të brendshëm:214/17/037/22 konstatojme se Vendimi i Autoritetit Kontraktues per Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit si dhe Letra standarde për eliminim është i paligjshëm ngase është bërë në kundërshtim me nenet e përcaktuara më poshtë duke demtuar interesin materialo - financiar te Kompanise 'BENI DONA PLAST'Shpk ne fitimin e kontrates publike në mënyrë të rregullte dhe ligjore .

Shkeljet e dispozitave ligjore nga ***Policia e Kosovës janë*** mëse vijon:

- *Eshte shkelur neni 1, i Ligjit te Prokurimit Publik nr. 04 / L – 042 (Ifrytëzimi efektiv transparent dhe i drejt i fondeve publike);* i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092

- *Eshte shkelur neni 6, i Ligjit te Prokurimit Publik nr. 04 / L – 042 (;kost efektiviteti dhe ekonomiciteti* i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092

- *Eshte shkelur neni 59, i Ligjit te Prokurimit Publik nr. 04 / L – 042 (ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve* i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092

- Është shkelur neni 41 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik,

- Është shkelur neni 36 i Ligjit të Prokurimit Publik nr.04/L-042(Procedurat e kuotimit të çmimeve)

- Është shkelur neni 61 i Ligjit të Prokurimit Publik (Tenderet jo –normalisht të ulët)

- *Eshte shkelur neni 10, i Ligjit te Prokurimit Publik nr. 04 / L – 042 Mjetet për promovimin e Transparencës* i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092 dhe neni 7 pika 3 e Rregullores nr.2/2017.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania 'BENI DONA PLAST'Shpk më poshtë do të prezentoje faktet dhe argumentet në menyrë të qartë dhe koncize për të demonstruar lëshimet dhe shkeljet ligjore të Autoritetit Kontraktues për tenderin: Shërbime Hoteliere në Hapësirat e Objekteve të *Policis së Kosovës me nr. prokurimi 214/17/1875/221.dhe ate të brendshëm* 214/17/037/221

Kompania 'BENI DONA PLAST'Shpk në bazë të nenit 111, paragrafi 1, nenparagrafi 1.5 te LPP-se ka interes materialo-juridik në parashtrimin e Ankesës në Organin Shqyrtues te Prokurimit nga se është dëmtuar rëndë nga Vendimi i Autoritetit Kontraktues në Anulimin e Tenderit sepse ka qenë Ofertuesi i përgjegjshëm dhe ka plotesuar te gjitha kerkesat dhe kushtet e percaktuara ne Dosje të Tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Pikat e ankeses – argumentet e potencuara jane mëse vijon:

Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës, me daten 26.06.2017 ka publikuar Njoftimin per Anulimin e aktivitetit te prokurimit per Shërbime Hoteliere në Hapësirat e Objekteve të Policisë së Kosovës *me nr. prokurimi 214/17/1875/221 dhe ate të brendshëm 214/17/037/221.ndërsa me datë 27.06.2017 në e-Mailin zyrtarë të Kompanisë Beni Dona Plast Shpk ka përcjell Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar sipas tyre se një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit (Njoftimi për Anulim) ndërsa sipas Letrës standarde citojmë: se Kompania Beni Dona Plast Shpk i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara, mirëpo nuk mund të jetë e përgjegjshme për arsye se çmimet e ofruara nga operatori ekonomik janë çmime të larta të krahasuara me çmimet e kërkesës së hartuar nga komisioni i Njësisë kërkuese të autoritetit kontraktues si dhe çmimet e tregut fund i citatit.*

Kompania 'BENI DONA PLAST'Shpk kundërshton Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e tenderit për arsye se sipas mendimit tonë jemi Ofertues të Pergjegjeshem dhe cmimet e ofruara për Lot 1 dhe Lot 2 kanë qenë cmime të tregut bile dukshëm më të favorshme se çmimet e tregut dhe Jo te marr Vendim të paligjshëm në Anulimin e Tenderit.

Prandaj, e konsiderojme si Vendim subjektiv dhe jo ligjor, Vendimin e Autoritetit Kontraktues per